



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



KUVENDI KOMUNAL

01 Nr. 14 /24

Më 31.07.2024

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 pika (d), neni 14 paragrafi 14.1 lidhur me 17 pikat (a, c, e dhe s) neni 40 paragrafi 40.2 Ligji për Vetëqeverisje Lokale 03/L-040, lidhur me dispozitat e Ligjit për Planifikim Hapësinor, Statutit të Komunës së Mamushës, kërkesës së Parashtruar nga MASHT, për sigurimin e lokacioneve për çerdhe me nr. 01-1495 e datës 17.05.2024, Planin Zhvillimor Komunal 2014-2023 01.Nr.-027-14, vërtetimi urbanistik me numër të protokollit 06 Nr.46-24 e datës 31.07.2024 nga Drejtoria për Planifikim, Urbanizëm Gjeodezi dhe Kadastër pranë Komunës së Mamushës Kuvendi Komunal në seancën e mbajtur me datën 31.07.2024 mori këtë:

V E N D I M

Caktimin e Lokacionit për ndërtimin e objektit të Çerddes në Komunën e Mamushës.

Neni 1

Miratohet kërkesa e parashtruar nga MASHT për caktimin e Lokacionit për ndërtimin e objektit të Çerddes në Komunën e Mamushës.

Neni 2

Lokacioni nga neni 1 i këtij vendimi gjendet në kuadër të Planit Zhvillimor Urban i miratuar me Vendim të KK Mamushë me 01-nr027-14. datë 31.07.2024, parcela Kadastrale me nr. të ngastër kadastrale P-73213054-01834-0 me sipërfaqe prej nga 5146 si parcele e tërësishme, e cila bazuar në certifikatën të nxjerr nga Njësia Kadastrale pranë Komunës së Mamushës e njëjta del të jetë në pronësi Pasuria Shoqërore Shkolla Filllore.

Lokacioni si në nenin 1 të këtij vendimi caktohet duke u mbështetur në Kërkesën nga MASHT me nr. nr. 01-1495 e datës 17.05.2024, Certifikata e Pronës dhe kopjen e planit.

Neni 3

Pjesë përbërës të këtij vendimi janë skicat e lokacionit të cekur në pikën II të Këtij vendimi dhe ekstrakti nga Plani Zhvillimor Urban.

Neni 4

Kompetente për zbatimin e këtij vendimi është Drejtoria e Arsimit Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria për Planifikim, Urbanizëm dhe Gjeodezi Kadastër.

Neni 5

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPI-ës dhe publikimit në gjykatë në wep-faqen e Komunës së Mamushës.

ARSYETIM

Në bazë të Kërkesës nga MASHT me nr. nr. 01-1495 e datës 17.05.2024, me të cilën kanë kërkuar caktimin e lokacionit me qëllim të ndërtimit të çerdhes për Komunën e Mamushës, Drejtoria e Arsimit ka zhvilluar takim me Drejtoria për Planifikim, Urbanizëm dhe Gjeodezi Kadastër, drejtoria përkatëse në bazë të kërkesës së lartcekur ka identifikuar lokacionin për ndërtimin e çerdhes e cila gjendet në kuadër të Planit Zhvillimor i miratuar me vendim të KK Mamushë 01.Nr.027-14 datë 31.07.2014 (Parcelë e propozuar për nderimin e Institucionit shkollor sipas Planit Zhvillimor Urban, shtrihet në zonën e destinuar për Arsim me sipërfaqe prej nga 5146 si parcele e tërësishme, e cila bazuar në certifikatën të nxjerr nga Njësia Kadastrale pranë Komunës së Mamushës e njëjta del të jetë në pronësi Pasuria Shoqërore Shkolla Fillore.

Bazuar në Gjendjen faktike konstatojmë se në kuadër të parcelës nuk ka objekt ekzistues, dhe është e përshtatshme për ndërtimin e Çerdhes. Harmonizimi i planeve ndërmjet veti do të bëhet gjatë procesit të hartimit të planeve hapësinore siç është Plani Zhvillimor Komunal dhe Plani Zhvillimor Urban.

*Zyrës së Kryetarit
Drejtoritë Kadastrit
Drejtorisë Arsimit
MAPL
Arkivit*

Kryesuesi i Kuvendit

Nedimedin Morina

